

Bashkia Klos



DISCLAIMER

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të Instrumentit të Planifikimit Financiar 2021 – 2023 dhe të dhënat e paraqitura në relacionin shoqërues të programit buxhetor afat – mesëm. Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Klos me asistencën e Projektit Bashki të Forta.



Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	4
Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2021 - 2023	5
Burimet e Financimit	6
Shpenzimet buxhetore	7
Administrimi i bashkisë	8
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	10
Kujdesi social për personat familjet dhe fëmijët	11
Rrjeti rrugor	13
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollorin	16
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	18
Furnizimi me ujë	21

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare të mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë e cila paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për tu përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për tu përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për tu përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Bashkia Klos



Bashkia Klos e pozicionuar në pjesën qendrore-malore të vendit përbëhet nga 13 Njësi Administrative (Klos, Suç, Gurrë dhe Xibër) me sipërfaqe prej 357.48 km². Sipas Censurit të vitit 2011, Klosi ka 16,618 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 20,281 banorë. Ka një densitet prej 58.24 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Klosi kufizohet në veri me bashkinë e Matit, në perëndim me bashkinë e Krujës, në jug-perëndim me bashkinë Tiranë, në jug-lindje me bashkinë Bulqizë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Klosit.

EKZEKUTIVI Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Klos për zgjedhjet vendore të vitit 2019 ishte 15,594 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 35,47%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PSSH, PAAK.

Kryetari i Bashkisë është **Z. ILMI HOXHA**

Bashkia është e organizuar në zyra që përfshijnë: financë dhe buxhet, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i territorit, policia bashkiake, zyra juridike, administrata dhe burimet njerëzore, arsim dhe sport.

EKONOMIA Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore. Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor dhe historik, si dhe industria e mineralit të kromit në minierat private të Cërujës.

Në zhvillimin e ardhshëm të territorit janë përcaktuar 3 drejtime kryesore të zhvillimit.

- ✿ Zhvillimi ekonomik i mbështetur në industrinë e minerare
- ✿ Promovimi i turizmit malor si një potencial i rëndësishëm zhvillimi
- ✿ Mbështetja e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë

Bashkia ka mbyllur një vit të vështirë pandemik në 2020 prezent edhe në vitin 2021, që sjell sfida të rëndësishme në zhvillimin e saj lidhur me:

- ✿ Mbrojtja e shtresave në nevojë dhe biznesit për të kapërcyer situatën e vështirë COVID '19.
- ✿ Mbështetja e ekonomisë kryesisht të industrisë minerare dhe bujqësisë.

Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2021 - 2023

Bashkia ka përgatitur një buxhet realist dhe të ekuilibruar. Shlyerja gradualisht e detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara do të përmirësojë marrëdhëniet kontraktuale të bashkisë kundrejt biznesit.


Shërbimet sociale për PAK, shërbimet sociale për familjet dhe fëmijët, administrata, rrugët, arsimit bazë dhe parashkollor, menaxhimi i sistemit vaditës dhe kullues zënë pjesën më të madhe në financimin e buxhetit të bashkisë për tre vitet e ardhshme. Këto 6 shërbime zënë mbi 84% të buxhetit të bashkisë. Investimet e bashkisë për vitin 2021 janë në vlerën 30 milionë lekë. Investimet synojnë përmirësimin e rrugëve në njësitë administrative (kryesisht rrugë rurale në fshtrat Dars, Gurrë dhe Gurrë e vogël) si edhe lagjeve brenda në qytetin Klos si edhe rikonstrukcionin e ujësjellësit dhe rehabilitimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Prioritete të buxhetit për vitin 2021 janë menaxhimi i sistemit vaditës dhe kullues, shërbimet publike, kujdesi social për familjet dhe fëmijët si edhe mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile financimi i të cilave ka rritjen më të lartë kundrejt vitit 2020 kundrejt gjithë shërbimeve të tjera që ofron bashkia financimi i të cilave vjen me ulje.

Bashkia synon përmirësimin e efikasitetit financiar – me të njëjtat fonde ofrohen më shumë shërbime për komunitetin.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)	NDRYSHIMI	2018	2019	2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023
	-19%	519,462	624,689	618,640	501,290	511,487	547,579
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
	Huamarrje						
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	2,850	6,900	200	200	200	200
	Të ardhura nga taksat lokale	14,623	56,130	11,619	11,619	11,619	11,619
	Të ardhura nga tarifa vendore	8,460	15,060	14,550	15,050	15,050	15,050
	Të ardhurat e tjera	2,396	42,201	80,683	36,801	37,001	37,201
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	253,593	252,145	267,483	242,669	242,943	264,180
	Transferta e pakushtëzuar	131,261	134,094	137,653	131,552	141,275	151,830
	Transferta specifike	84,294	75,167	77,187	63,400	63,400	67,500
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi me destinacion	0	0	6,182			
	Trashëgimi pa destinacion	21,985	42,992	23,084			




Bashkia financohet në raportin rreth 17% me 78% nga të ardhurat e veta dhe transfertat e qeverisë qendrore. Për shkak të situatës së rëndë covid gjatë tre viteve të ardhshme ky raport do të bjerë për kontributin e financimit nga burimet e bashkisë. Gjatë vitit 2020 mbledhi rreth 11% më pak të ardhura nga taksat, tarifat vendore, ndërkohë që në tërësi financat e bashkisë ranë me vetëm 1% pasi zotimet e qeverisë qendrore për bashkinë u respektuan. Në tërësi për vitin 2021 bashkia planifikon:

- ☀ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë do të bien me rreth 19% kundrejt vitit 2020;
- ☀ Të ardhurat nga burimet e veta do të bien me rreth 41% kundrejt vitit të kaluar. Duke reflektuar kështu vazhdimin e situatës së rëndë pandemike me efekt mbi zhvillimin ekonomik dhe biznesin në tërësi.

Figura 1. Pesha e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Shpenzimet buxhetore



Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 planifikojnë të bien me rreth 23% duke reflektuar kështu edhe rënien e financimit të përgjithshëm të bashkisë kundrejt vitit 2020. Më poshtë shkurtimisht jepet performanca e programeve buxhetore që zënë peshën më të madhe të buxhetit të bashkisë:

- ✿ Administrimi i bashkisë
- ✿ Kujdesi Social për PAK
- ✿ Kujdesi social për familje dhe fëmijë
- ✿ Rrjeti rrugor rural
- ✿ Arsimi bazë dhe parashkollor
- ✿ Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit
- ✿ Furnizimi me ujë

Administrimi i bashkisë

VITI 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
	76,150	16.1%	-24.1%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
↑	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)	0.00	150.0	20.0	-66.7	0.0
↓	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	8.40	15.0	18.4	13.3	10.0
↑	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajtuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	1.75	1.8	2.4	2.3	2.0

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Ditë trajnimi në total	35.0	55.0	60.0	45.0	45.0
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	10.0	25.0	30.0	10.0	10.0
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	20.0	30.0	35.0	20.0	15.0
Numri total i personave të trajnuar	20.0	30.0	25.0	20.0	25.0
Numri total i punonjësve të bashkisë	238.0	200.0	190.0	150.0	150.0

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Ditë trajnimi në total	35.0	55.0	60.0	45.0	45.0
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	10.0	25.0	30.0	10.0	10.0
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	20.0	30.0	35.0	20.0	15.0
Numri total i personave të trajnuar	20.0	30.0	25.0	20.0	25.0
Numri total i punonjësve të bashkisë	238.0	200.0	190.0	150.0	150.0

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
Administrimi i bashkisë	70,792	141,788	30,004	22,336	47,967
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Adoptimi dhe Rik. I godines se ish komunes		2,000			
Blerje Kompjuter per Keshillin		100			
Blerje mat.per rik.rrugesh+banesa per te varfer	7,814				
Kompjuter per zyren e urbanistikes		330			
Kontr. Rikonstruksion zyra e keshillit	2,094	741			
Mbikq.rikonst.zyra e Keshillit	25				

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë.

Performanca e administratës së bashkisë do të përmirësohet duke:

- ✧ Respektuar kuadrin ligjor dhe rregulloret e administratës – më pak masa disiplinore për ta;
- ✧ Rritur kapacitetet profesionale të administratës – mesatarisht më shumë ditë trajnimi për punonjës
- ✧ Rritur qëndrueshmërinë e administratës – më pak lëvizje të personelit nga puna

Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
VITI 2021	114,940	24.3%	3.1%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 2: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të sëmurë dhe me aftësi të kufizuar
Rritja ose përmirësimi i skema / institucioneve që ofrojnë shërbime për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
↓	Perfitimi monetar (në lekë) për persona të sëmurë dhe PAK	131,974	0	124,935	124,935	
↓	Persona të mbështetur me pagesë invaliditeti (Ndryshimi vjetor në %)	19.2	-1	-1	0	0

Produkti	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti	932	925	920	920	920

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për mbështetje monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht ose plotësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.). Performanca e e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

Më shumë persona të mbështetur me pagesë invaliditeti.

Kujdesi social për personat familjet dhe fëmijët

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
VITI 2021	99,365	21%	9%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për personat familjet dhe fëmijët: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Familje dhe fëmijë në nevojë të mbështetura nga bashkia	6.000	8.000	8.000	8.000	8.000
Viktima të dhumës në familje dhe / ose viktima të trafikuar të mbështetura nga bashkia	9.000	10.000	10.000	10.000	10.000

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për famijet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve.

Performanca e këtij shërbimi do të përmirësohet duke realizuar:

- ✱ Më shumë familje dhe fëmijë në nevojë të mbështetur nga bashkia: fëmijë pa përkujdesje prindërore, në qendra ditore për fëmijë,
- ✱ Më shumë viktime të dhunës në famije apo trafikim të mbështetur,

Shpenzimet e bashkisë për të ofruar shërbim në qendrat sociale është dyfishuar në vitin 2020, fonde të cilat do të dyfishohen edhe në vitin 2021 e në vazhdim.

Rrjeti rrugor

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
VITI 2021	55,580	11.8%	-27.3%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Përmirësimi i komunikimit ndërlokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
↑	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në %)	1.54	1	1	2	0
↑	Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në %)	1.55	1	1	3	0
→	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në %)	-11.34	14	0	0	0
→	Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në %)	-11.34	14	0	0	0
↑	Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në %)	0.00	25	20	0	0
↑	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	566,525.25	383,361	275,150	268,420	264,659

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	86	98	98	98	98
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	0	0	0	0	0
Rrugë rurale të mirëmbajtura nw km linear	86	98	98	98	98
Rrugë urbane të mirëmbajtura nw km linear	0	0	0	0	0

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	198	200	202	207	207
Rrjeti rrugor rural	196	197	199	204	204
Rrjeti rrugor urban	2	3	3	3	3

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithw rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj.

Performanca e administratës së bashkisë do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Rritjen e projekteve të investimit që synojnë asfaltimin e rrjetit rrugor për të përmirësuar gjendjen e tij dhe rritur komunikimin lokal me qendrat e shërbimeve të rëndësishme publike si shkolla, ambulanca, komunikimin për biznesin, et,;

Uljen e kostos për një kilometër linear rrugë të asfaltuar apo të mirëmbajtur duke përmirësuar eficiencën e përdorimit të parasë publike.

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
Rrjeti rrugor rural	70,792	141,788	30,004	22,336	47,967
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Hapje aksi rruga Mali I Lezit Gurre	887				
Kol. Hapje rrug. nd. Boksesh ura ne fsh. Bashk. Klos	12				
Kol.rik.rr. Nj.Ad.G.+Hap. rr.Mali Lezit+Nd.ura Liçi	6				
Kolaudim rik.pjesshem urban qytetit klos	25				
Kolaudim sistemim asfaltim I lagjeve te qytetit klos	15				
Kontr. Rikualifikim urban I Qytetit	5,333	10,143			
Kontr. Sistemim asfaltim ne lagjet e qytetit Klos	3,000	4,494	1,977		
Mbik. Hapje rrug.nd. Boksesh,ura ne fsh.bash. Klos	113				
Mbik.rik.rr. Nj.Ad.G.+Hap.rr.Mali Lezit+Nd.ura Liçi	56				
Mbikq.rikual.pjesshem urban I qytetit	75				
Mbikq.sistem.asfaltim ne lagjet e qytetit	78				
Nd.Ura te Liçi	583				
Ndertim akse rruge ne fshatra		1,000	1,210		
Ndertim muresh ne rruget e Bashkise	1,296	2,449			
Rik ne rruget e Njesise Ad.Gurre	1,527		1,300		
Rik.rruge kal. Pet,rruga G. Vogel,nd.ure lela-Arriku	2,149	3,389	2,000		
Rikonst.rruga Dars		1,408	1,076		

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollorin

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
VITI 2021	33,500	7.5%	-5.8%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollorin: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
→	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	67.44	69	70	69	69
→	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	8.43	8	8	8	8
→	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve)	13.84	14	14	14	14



kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)					
Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Lekë/institucion)	2,869,217.39	1,638,705	1,543,478	1,556,522	1,652,174

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	23	23	23	23	23
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	117	118	117	116	116
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	26	26	25	27	27

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	408	420	418	425	425
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	192	193	192	194	194
Mësues në sistemin parashkollor	31	31	31	30	30
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	605	610	600	612	620
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	45	45	44	46	46
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	1,619	1,630	1,610	1,620	1,620

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave. Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve.

Performanca e këtij shërbimi do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor dhe atij 9 vjeçar nga nxënësit;
- ✿ Uljen e kostos së një institucioni arsimor duke përmirësuar eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim

Shpenzimet për këtë funksion parashikohen me ulje duke reflektuar tenden e përgjithshme të gjithë buxhetit të bashkisë.

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	70,792	141,788	30,004	22,336	47,967
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Kolaud.Rikonst.amb.brendsh.,dhe jash. kopsht.klos	1.0				
Mbikq.Rik.ambj.brendsh.,dhe jash. te kopsht.klos	8.0				
Rik.ambjenteve te kopshtit klos	942.0				

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
VITI 2021	16,669	3.5%	64.7%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Mbështetja e prodhimit bujqësor dhe aktivitetit të fermerëve nëpërmjet menaxhimit të infrastrukturës sekondare dhe terciare të kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
↑	Kilometra linear kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (Raporti në %)	3.90	5	5	6	6
→	Kilometra linear kanal ujitës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (Raporti në %)	3.25	6	6	6	6
↑	Kosto mesatare për 1 km linear kanal ujitës dhe kullues të menaxhuar (Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim kundrejt kilometrave total te sistemit ujites dhe kullues Lekë/për km)	3,896,364	1,124,710	1,852,111	1,459,000	2,309,000
→	Numri i familjeve përfituese të shërbimit të vaditjes dhe kullimit (Ndryshimi vjetor në %)	0.00	0	0	0	0
→	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (Ndryshimi vjetor në %)	0.00	0	0	0	0
→	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (Ndryshimi vjetor në %)	0.00	0	0	0	0
↑	Sipërfaqja e tokës bujqësore e kultivuar kundrejt totalit të tokës bujqësore (Raporti në %)	71.88	76	78	78	78

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Familje përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	3,900	3,900	3,900	3,900	3,900
Kanal kullues i pastruar (në km linear)	3	4	4	5	5
Kanal ujitës i pastruar (në km linear)	3	5	5	5	5
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim në ha	203	203	203	203	203
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje në ha	2,076	2,076	2,076	2,076	2,076
Sipërfaqe e tokës së kultivuar në ha	3,400	3,600	3,700	3,700	3,700

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
----------	------------	-----------------	-----------	-----------	-----------

Sipërfaqe e tokës bujqësore (fondi bujqësor sipas inventarit) në ha	4,730	4,730	4,730	4,730	4,730
Sistemi kullues (në km linear)	77	80	82	83	83
Sistemi ujitës (në km linear)	77	77	77	77	77

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ndërtimin dhe organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, nën përgjegjësinë e bashkinë në të gjitha njësitë administrative të saj. Me investime të rëndësishme të përvitshme nga buxheti i bashkisë performanca e këtij shërbimi do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Bërjen funksionale të kanaleve kulluese dhe vaditëse – pastrimin e mëtejshëm të tyre
- ✿ Rritjen e sipërfaqes bujqësore të mbuluar me shërbimin e vaditjes dhe kullimit
- ✿ Uljen e kostos së pastrimit të një kilometri linear kanal kullues dhe vaditës duke rritur eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim të ofruar nga bashkia.

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	70,792	141,788	30,004	22,336	47,967
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Bashkefinansim me donatoret		2,821			
Blerje tub per kanalet vaditese	3,463	1,505			
Blerje tubash per ujesjellesat e Bashkise	2,825				
Ndërtim Sifoni Fullqet	1,978		1,500		
Rik. Te ndryshme ne ujesjells,kanele,rruge,xhami dhe qytet	1,405				
Sherbime dhemirembajtje kanale vaditese	1,909	491	642		

Furnizimi me ujë

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
VITI 2021	14,380	3%	-56.2%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korente dhe investim

Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
↑	Orë ujë në ditë (Ndryshimi vjetor në orë)	0.00	2.00	0.00	2.00	0.00
→	Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	28.50	28.64	28.64	28.64	29.00
→	Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (plus investime dhe amortizimi) (në %)	46.71	49.55	49.55	49.55	50.00



Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzime korente (në %):	46.76	49.60	49.60	49.60	50.00
---	-------	-------	-------	-------	-------

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm (mesatarisht orën në ditë)	4	6	6	8	8
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	5,870	5,900	5,900	5,900	5,900

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi) në Lekë	15,843,000	15,843,000	15,843,000	15,843,000	15,843,000
Popullsia totale e bashkisë	20,598	20,599	20,600	20,600	20,600
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm	7,400,000	7,850,000	7,850,000	7,850,000	7,850,000
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm	15,826,000	15,826,000	15,826,000	15,826,000	15,826,000

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përballeshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitetet në vijim do të vazhdojnë investimet të rëndësishme për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë. Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Më shumë personave u është ofruar uji i pijshëm
- ✿ Më shumë territor është mbuluar me furnizimin e ujit të pijshëm
- ✿ Rritja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët
- ✿ Mbulimi i koston së prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nga tarifatat e shërbimit.

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
Furnizimi me ujë	70,792	141,788	30,004	22,336	47,967
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Mbikq.Rikonstuksion ujesjellesi		300	300	400	794
Rikonstuksion ujesjellesi		10,000	20,000	21,936	47,173

